

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 RITUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 10-1992/2
 Data / Datum / Date: 05/06/2026
 Shtojca / Dodaci / Annex: -2-
 PRISHTINË/A (2025)



MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE
 AVOKATURA SHETËTORE
 DRŽAVNO PRAVOBRANILAŠTVO - STATE ADVOCACY OFFICE

Njësia Org. AVSH Nr.Prot: 10
 Org.Jedinica AVSH Broj Prot: 10
 Org.Uni AVSH Prot.No: 10
 Nr.i faqeve 2 Data: 05/06/2026
 Br.stranica 2 Datum: 05/06/2026
 No pages 2 Date: 05/06/2026
 Prishtinë-Prishtina-Prishtina

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Avokatura Shtetërore - Državno Pravobranilaštvo - State Advocacy Office

Nr. 47/2026
 Datë: 05.06/2026

Në mbështetje të nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtar, Nr.7/01 mars 2019), dhe në përputhje me nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ushtruesja e detyrës së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror të Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e Vendimit Nr.32/2025

1. Shfuqizohet Vendimi Nr.32/2025 i datës 23.12.2025 për pezullimin nga marrëdhënia e punës të z. Naim Krasniqi, Avokat Shtetëror në Avokaturën Shtetërore të Republikës së Kosovës.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, z. Krasniqi rikthehet në pozitën e mëparshme të punës.
3. Obligohet Departamenti për Buxhet dhe Financa dhe Divizioni për Burime Njerëzore i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me datë 23.12.2025 z. Naim Krasniqi, Avokat Shtetëror në Avokaturën Shtetërore të Republikës së Kosovës është pezulluar sipas detyrës zyrtare në pajtim me paragrafin 1.6 të nenit 69 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik.

Më datën 19.05.2026, avokati Arbër Jupolli, përmes shkresës zyrtare, ka kërkuar që z. Naim Krasniqi të rikthehet në vendin e punës, pasi që ndaj tij më datën 17.05.2026 është ndërprerë masa e arrestit shtëpiak dhe i njëjti tashmë mbrohet në liri.

Me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve procedurale në përputhje me legjislacionin në fuqi, Divizioni për Burime Njerëzore i Ministrisë së Drejtësisë i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë me kërkesë për konfirmimin e statusit të masës së arrestit shtëpiak të caktuar ndaj z. Naim Krasniqi.

Më datën 04.06.2026, nga Gjykata Themelore në Prishtinë është pranuar njoftimi zyrtar, me të cilin konfirmohet se masa e arrestit shtëpiak ndaj z. Naim Krasniqi ka përfunduar më datën 17.05.2026. Në njoftim gjithashtu theksohet se Prokuroria kompetente, në çështjen konkrete, nuk ka paraqitur kërkesë për vazhdimin, zëvendësimin apo ndryshimin e kësaj mase, për rrjedhojë ndaj të njëjtit nuk është caktuar ndonjë masë tjetër për sigurimin e pranisë në procedurë.

Bazuar në rrethanat e sipërpërmendura dhe dokumentacionin zyrtar të pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Fitore GAJTANI**
Ushtruese e detyrës së Avokatit
të Përgjithshëm Shtetëror

Vendimi i'u dërgohet:

- *Z. Naim Krasniqi;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës;*
- *Departamenti për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizioni për Burime Njerëzore dhe*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*